

ARJANA SEITI

FJALORËT SHUMËGJUHËSH QË PROMOVUAN KOMBE*

[Fjalorthi Tetraglos Balkanik i Dhanil Mihal Adham Haxhiut]

Objekt i këtij punimi është paraqitja e fjalorëve shumëgjuhësh përgjatë fillimeve të njehsimit të gjuhës shqipe [shekulli XIX]. Në vëmendje do të jenë përpjekjet e klerikut Dhanail Adham Haxhiut, të dhëna përmes botimit të tij Fjalorthi Tetraglos Balkanik, i cili shkon përtej një fjalori; apo kur autori shkon përtej një përkthyesi, kur këndvështrimi kulturor i tij përfshin besime dhe praktika tradicionale ballkanike.

Dokumentimi i vonuar i gjuhës shqipe shekuj më vonë se ç'ishin dokumentuar shumë gjuhë të tjera nuk ndikoi në bjerrjen e ligjërit. Pas Mesharit të Buzukut, si dokumentuesi i parë për shekuj të tërë, do të ndërmerreshin shumë punë përgatitore nga një plejadë e tërë, që falë kontributit të tyre meritojnë të quhen gjuhëtarë, etnografë, folkloristë, historianë, pasi çuan drejt dokumentimit të kësaj gjuhe. Është vënë re se shkrimit të gjuhëve ballkanike dhe kryesisht njehsimit të alfabeve përgjatë shekullit XIX u kanë paraprirë përveç fjalorëve dygjuhësh, që janë më të shumtë në numër, edhe ata shumëgjuhësh, tek të cilët do të fokusohemi. Synimi për të mos lejuar asimilimin e gjuhës mëmë, i vë autorët në sprovë përgatitore të këtyre fjalorëve, të cilët më së shumti janë trajtuar si bisedimorë, gjë që të bind se praktikiteti dhe komunikimi kanë qenë domosdoshmëri. Do të doja të theksoja faktin se si botimi dhe qarkullimi i fjalorëve shumëgjuhësh nëpër Ballkan nxit gjuhëtarët për të bërë kërkime dhe interpretime, ndonjëherë edhe nacionaliste për aktualitetin, duke i aftësuar akoma më shumë për sa i përket shkencës së filologjisë, por njëkohësisht sot në një këndvështrim tjetër si ndërkomunikim kombesh, gjuhe dhe shoqërie elitare.

Nga propaganda e shekullit XVIII kuptohet qartë që po vihej një shenjë barazie mes asimilimit të kombeve me asimilimin e gjuhës së ligjëruar dhe ca më shumë asaj të shkruar. Kjo situatë që kish kaluar përtej

*Një falënderim të veçantë për këtë punim shkon për prof. as. Spiro Gjonin, i cili më vuri në dispozicion Dorëshkrimin e studiuesit Ilo Mitkë Qafëzezi, ku mes të tjerave gjendej Fjalori i Voskopojarit. Materiali gjendet në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike.

Ballkanit bëhet stimuluese për lindjen e dukurisë së nacionalizmit. Përdorimi i dygjuhësisë së ligjëruar nga ballkanasit mund të quhej normal. Po t'i referohemi vetëm gjyshërve tanë, ata në historitë e tyre gojore tregojnë se si shkonin në shkollat turke apo greke dhe mësonin shkrimin përkatës, ndërkohë që gjuha e folur ishte ajo e mëmës. Edhe Shqipëria kishte kohë që e njihte dukurinë e të folurit shumëgjuhësh, por jo të të shkruarit e ca më shumë të shqipes. Para se të ndalem tek autorët e fjalorëve disa gjuhësh, do të donim të vinim theksin te fakti se me gjithë arsimimin e tyre, ndoshta dhe autodidakt, janë këto autorë që gëzojnë meritat për njohjen dhe komunikimin ndërballkanas. Domosdoshmëria dhe pasioni për të ndërmarrë një punë të tillë u thellua ndër vite, kur më pas këta autorë deklarohen nga albanologët si promotorët e parë të shkrimit dhe studimit të shqipes.

Do mundohemi të kujtojmë disa nga fjalorët shumëgjuhësh duke filluar me kryepriiftin Teodor Kavalioti, i cili kish botuar një Fjalor i greqishtes, vllahishtes dhe shqipes popullore, përfshirë në abetaren e tij [Protopeiria, 1710] me 1170 fjalë; si dhe fjalorin *Latinisht-vlleh-shqiptar*, të riprodhuar nga Thunmann nga ku historiani suedez mori argumente bindëse rreth autoktonisë së shqiptarëve në trojet ilire.

Thimi Mitko në fillimet e shekullit XIX harton fjalorin trigjuhësh italisht-greqisht-shqip, kur vetë personalisht ndodhej në Egjipt dhe jo në ndonjë hapësirë gjeografike që i përkiste Italisë, Greqisë apo Shqipërisë. Fjalori i tij tri gjuhësh shquhet për një terminologji etnokulturore¹ me një sasi fjalësh leksikore shqipe, rreth 5280². Nga renditja e gjuhëve, shqipja vjen e fundit, por jo si më e parëndësishmja. fjalori është përgatitur në dy pjesë, tematik dhe bisedimor, por aspak si rrëfyes i një ngjarjeje, por me një sasi fjalësh të shumta në ligjërim. Kështu për shembull Fjalori tematik zë fill: Për botën faresej. Perëndija, a zoti-y-në, a fare –miri. Krijuasi, basi, a Qielli, a qelli. Dhe-u. Diell-i, a dill-i. Det-i. Kërnall-i. Hënë-a. Yje-t. Yll' i ditës. Yll' i natës. Ujë-i, a ujë-t. Ziarri, a ziarm-i. Mal-i. Kodrë-a. Breg-u. Lumë-i. Liqer-i.³ Fjalët janë të veçuara dhe vetëm një të shkolluari do t'i shkonte në mendje se ka një lidhje logjike mes tyre që të çojnë drejt kozmogonisë. Ndërsa në pjesën bisedimore fjalitë kanë lidhje tipike bisede, p.sh.: Është e bukurë vaizë. e ëma do të jetë ajo zonjë atie. Ehj, zot sa e bukur grua!⁴. Duket qartë që përpilimi i këtij fjalori përfshin të dy

¹A. Xhagolli, 2015, f. 330-337.

² Sh. Sala, 2013, f. 62.

³ Po aty; 2013, f. 97.

⁴ Sh. Sala; 2013, f. 175.

dialektet e Shqipërisë dhe është realizuar ndoshta falë hulumtimit të tij në emigrim.

Gjorgji Pulevski jetën dhe veprimtarinë e tij e kaloi nëpër Ballkan si luftëtar kundra perandorisë osmane, pa lënë mënjane pasionin e tij për leksikografinë. Në bazë të të dhënave, ai ka qenë në një moshë pjekurie rreth të pesëdhjetave kur ka punuar për dy fjalorët e tij disagjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht me 2560 fjalë e shprehje shqipe, të botuar në Beograd, si dhe fjalorin bisedimor tri gjuhësh Fjalor nka tre gjuha maqedonisht-shqip-turqisht⁵, i tipit pyetje – përgjigje, botuar sërish në Beograd dy vjet më vonë se i pari me kolonë bazë maqedonishten. Studiuesit kanë vënë re dhe një farë devijimi në përkthim. Kështu në shtyllën maqedonisht shkruan: Maqedonasit janë popull dhe se atdheu i tyre quhet Maqedoni; ndërsa në shtyllën shqip shkruan: Shqiptarët janë popull që jetojnë edhe në Maqedoni⁶. Pra nuk kemi një përkthim të mirëfilltë. Më tej studiuesit e këtij fjalori theksojnë se ekzistojnë rreth 7 faqe [41-48] të cilat nuk përkthehen as në gjuhën shqipe dhe as në atë turke. Nuk do t'i japim aspak rëndësi asaj për çfarë flitet në ato faqe të papërkthyer, por a do të quhej fjalor i mirëfilltë një vepër e tillë apo do të trajtohet si një fjalor që i shërben qoftë dhe fare pak ndërkomunikimit.

Sipas të dhënave në Tiranë, në Arkivin e Shtetit ruhet një fjalor tri gjuhësh latinisht-greqisht-shqip që daton në vitin 1860, i përgatitur nga mjeku Jani Vaja, me një sasi fjalësh shqipe rreth 1000, të shkruara me shkronja latine⁷. Autori kishte pohuar se e shkroi për persona që studionin gjuhën latine. Një deklaratë e përafërt me këtë do të jepte kohë më parë dhe Dhanil Voskopojari për gjuhën greke. 'Të kesh në mendje se fjaluar në katër gjuhëra u pat ndërtuar vetëm e vetëm, që fëmijët e Mezodakëve të stërviten me gjuhën rumishte [greke]... Qëllimi i shkrimtarit ka qenë vetëm e vetëm t'u japë djelmohave tjetër gjuhë të fjalëve dhe jo të bëjë dhaskalëri të thellë të punëve⁸. Në këtë kontekst duket sikur fjalorët porositeshin nga një familje, nga një fis apo etni, për t'u njohur me gjuhët [greke dhe latine] që tashmë ishin zyrtarizuar nëpër Ballkan, fakt që vë theksin te këmbëngulja për të përhapur dijet. Këto thënie vënë në pedestal

⁵ Hamiti, A. – Osmani, I. [Shkup], *Ndihmesa e Thimi Mitkos në leksikun e Shqipes*, Tiranë 2015, f. 83-89.

⁶ A. Hamiti – I. Osmani [Shkup]; 2015, f. 83-89.

⁷ <http://telegraf.al/opinion/akademik-xhevat-lloshi>: 'Në hullinë e fjalorëve të shqipes me greqishten'

⁸ <http://telegraf.al/opinion/akademik-xhevat-lloshi>: 'Në hullinë e fjalorëve të shqipes me greqishten'

moralin e të nxënit duke lënë mënjanë se në çfarë gjuhe shkruhej, me shkronja greke apo latine. Megjithë përpjekjet e shumta për të shkruar shqipen përmes këtyre fjalorëve shumëgjuhësh, për elitën shqiptare ajo mbeti vetëm një sprovë.

Le të ndalemi shkurtimisht në fjalorin bisedimor katërgjuhësh të mjeshtrit Dhanili⁹, i njohur shkurt Voskopojari, me prejardhje arumune apo mezodak [Mezisë]. I nisur nga fakti se intrigohet për punimin e tij, falë dëshirës për të transmetuar te brezat, aktivitete për punën, edukimin apo urtësinë¹⁰. Megjithëse fjalori prej gjuhëtarëve quhet bisedimor, ai mund të trajtohet dhe si një fjalor rrëfimtar, gjë të cilën do të mundohemi ta japim përmes ndonjë shembulli. Thuhet se Voskopojari kishte qenë nxënës i Kavaljotit, por ndërkohë albanologu Robert Elsie paraqet një panoramë rreth situatës së Voskopojës ku thotë: ‘Shumë dijetarë grekë me emër vinin në Voskopojë për t’u dhënë mësim arumunëve, që përbënin shumicën e popullsisë. Akademia e Re nuk ishte institucion vetëm teologjik. Ajo gëzonte emër të mirë për mësimdhënien e greqishtes së vjetër, filozofisë, matematikës dhe fizikës ...’¹¹.

Dhanil Mihal Adham Haxhiu, një klerik dhe mësues, kish botuar një Fjalor katër gjuhësh (1802)¹² [Fjalorthi Tetraglos Balkanik], ku përveç tri gjuhëve të sipërpërmendura nga Kavalioti, vite më vonë kishte shtuar edhe bullgarishten¹³, falë bashkëpunimit me një klerik nga Ohri të quajtur Propapa Stefan¹⁴. Kjo është një nga arsyet që na ka shtyrë për t’u ndaluar te ky fjalor, i cili askokohe do t’u shërbente katër etnive të Ballkanit Jugor dhe ekzistenca e këtij fjalori duhet parë si fryt i një bashkëpunimi mes elitave të kohës.

Në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike rezulton ky fjalor, për të cilin një punë të përkushtuar ka bërë gjuhëtari Ilo Mitkë Qafëzezi¹⁵, dorëshkrimi të të cilit i jemi referuar. Sipas tij, fjalori u punua në vitet 1790 e më tej dhe u botua në Venedik në dy revista, në vitet 1793 dhe në 1802. Qafëzezi nuk heziton

⁹ I. M. Qafëzezi, *Dhanil Mihal Adham Haxhi Voskopojari*, Arkivi i IGjL.

¹⁰ Sipas: I. M. Qafëzezi, *Dhanil Mihal Adham Haxhi Voskopojari*, Arkivi i IGjL.

¹¹ <http://www.scribd.com/doc/27159724/Histori-e-Letersise-Shqiptare-Elsie-Robert-1995#scribd>

¹² Shënim: ky fjalor është ribotuar edhe nga Perikli Papahaxhi

¹³ S. Skëndi; 1980, f. 235.

¹⁴ Sipas I. M. Qafëzezi, këtë e kish deklaruar në punimet e tij profesori bullgar Ivan Shegarov në një varg studimesh etnokulturore të Ohrit.

¹⁵ I. M. Qafëzezi, *Dhanil Mihal Adham Haxhi Voskopojari*, Arkivi i IGjL.

të deklarojë se nga pikëpamja e shqipes Dhanili qëndronte më poshtë se Kavalioti, por si punim didaktik dhe lingistik fjalori i tij ka patur një sukses më të madh se Protopeiria¹⁶. William Leake, diplomat anglez pranë Ali Pashë Tepelenës, i njohur tashmë prej albanologëve, e kish ribotuar fjalorin pa ia përmendur fare emrin mjeshtrit Dhanili, por duke deklaruar ‘Këto shembëlla janë qitur, pasi patmë këmbyer shkronjat e alfabetit, prej një libri të vogël i quajtur Fjalor Katërgjuhësh i botuar me alfabet greqisht’¹⁷, ndërkohë që profesori Perikli Papahaxhi i Bukureshtit kishte ribotuar të gjitha pjesët e katërgjuhëshit duke e publikuar atë si lëndë didaktike, thuajse në të gjithë Ballkanin.

Sipas Qafëzezit, fjalori origjinal është shkruar me alfabet grek për të katër gjuhët. Ndërkohë Leake e boton fjalorin pa emrin e autorit dhe jo në gjuhën angleze, por kapërcen ndasitë fetare duke e ribotuar tetraglosin me shkronja latine vetëm për pjesën shqip-vllehisht dhe bullgarisht, duke i shtuar këtij fjalori edhe një gjuhë të pestë, ndoshta për t’i dhënë një hapësirë më ballkanike apo duke e legjitimuar atë si një lëndë didaktike për të gjithë të shkolluarit, qoftë në shkollat ku shkruhej me shkronja greke, qoftë në ato ku shkruhej me shkronja latine, si dy nga tri gjuhët zyrtare të Ballkanit në shek. XVIII. Të mos të harrojmë se osmanishtja ishte gjuha perandorake që kish zaptuar një pjesë të mirë të Evropës.

Fjalori vjen i ndarë në katër kolona: Alvanitika [shqip] - Voulgarika [bulgarisht] – Vlahika [vlahisht] – Romajka [greqisht]. Sipas Qafëzezit, gjuha shqipe e fjalorit origjinal është ruajtur si një mënyrë e volitshme për të krahasuar të folmen e shqipëtarëve me të tjerët¹⁸. I ardhur krejt ndryshe nga fjalorët që u shkruan kohë më vonë, ndërtohej në fjali të shkurtëra me 10-15 fjalë e ndonjëherë edhe më shumë. Janë 235 fjali të tilla, të cilat në këndvështrimin e një folkloristi rrëfejnë apo përshkruajnë ngjarje jetësore, besime, praktika, këshilla, supersticione, që e legjitimojnë si vepër didaktike për këtë shekull, tek i cila nuk u gjet mbështetje udhërrëfyese për hartuesit e fjalorëve të mëvonshëm. Pa ditur arsyet e mosreferimit të ky tekst didaktik, por duke aluduar, mund të themi se dikush e trajtoi veprën me nacionalizëm, dikush tjetër nuk pati mundësinë ta kalonte nëpër duar, dikush tjetër nuk zotëronte fatin e të lexuarit, ndaj sot po hedhim pak dritë mbi këtë fjalor, pse jo, pesëgjuhësh.

Fjalori nis me fjalinë:

¹⁶ Përkthim: [Përvojë e parë].

¹⁷ I. M. Qafëzezi, *Dhanil Mihail Adham Haxhi Voskopojari*; Arkivi i IGjL. f. 28.

¹⁸ Vepër e cituar, f. 28.

1. Perëndia bëri qiellin, dhenë, hënzën, yjet.
2. Dhe pastaj udhëroj detnë, gjolërat, lumërat edhe nxuar peshqit ngjhalat.
3. Përsëri tha edhe duallë sipër mbi dhet gjithë drurët.
4. Edhe është dheu plot më dru pe dushku, pe ahu, pe shelgu, pe plepi, pe selvie, pe borige.

Është mëse e qartë se kemi të bëjmë me mitin e krijimit të botës. Në shoqëritë e asaj kohe miti ishte histori e vërtetë e vyer, e shenjtë e për këtë duhej të bëhej i njohur edhe me anë të shkrimit. Mund të konsiderohet si një nga mënyrat e njohjes së mitit për pasardhësit e juglindjes së Shqipërisë, ku autori, klerik ortodoks, përhapit dijet e Biblës. Por në zonat rurale të veriperëndimit të Shqipërisë, ky mit, në pamundësi për t'u shkruar apo mësuar në shkollë, përcillej gojarisht te pasardhësit përmes këngës folklorike.

*Të lumtë na për t'lumin Zot,
qi s'jemi kenë e zoti na ka dhanë!
ka falë diell, hyj e hanë,
ka falë nier, orë e zanë,
ka falë shpez e gjanë,
ka falë fusha, kodra male¹⁹*

Në brendi të fjalorit fjalitë kanë më së shumti një lidhje logjike me njëra-tjetrën, pra nuk mungon konteksti, ka vijimësi në formën e një rrëfimi të një historie me tematikë të natyrës etnokulturore.

86. Të mos helmohesh pse nukë fitove këtë udhë/

87. Se fitimi edhe zarari ecënjë bashkë/

88. Po të gëzohesh pse gjete shtëpinë tënde të tërë.

89. Edhe shpëtuan djemtë e tu nga fruthi./

Nuk mungojnë raste të përshkrimit të ngjarjeve të përditshme në formë këshille apo besimi që lidhen me ritin e vdekjes.

193. Si të vdesë njeriu gjen ta vesh sipër mbë rogoz.

194. Edhe të rijë njëzet e katër sahat.

195. Edhe ashtu ta groponsh ndë varr të ri.

196. Edhe të ndaç bukë e të vogla kuleçë

197. Edhe të apsh ndë të veat tre vjet ta hapësh varrë.

198. Që ta shohësh, ai është i tërë i treturë.

Më poshtë vijon me fjali në formë këshillash mjekësore popullore, të cilat i nevojiteshin aq shumë njerëzisë, pikërisht kur flitet për fillimet e

¹⁹ Visaret e Kombit, Vëllimi II, 1937, f. 250.

shekullit XIX, kohë kur mjekësia shkencore nuk kish arritur të depërtonte në Ballkan.

75. *Kur të dhëmbinë sytë, goja, gjokësi, kërthiza, eshtërat, gjunjët, pulpët, thembëra, hudhër të mos hash edhe ashtu shëndoshesh*

100. *Edhe zgjebja dhbonetë me hi, po vetëm kur të perëndojë dielli.*

217. Po kur i ke këmbët e enjtura të mblethsh kërmij edhe breshka

218. Edhe ti çansh ndë mes edhe t'i vësh sipër mbi këmbëtë.

Mendova të shkëpus dhe një nga pjesët e fjalorit, ku rrëfimi ndalet te një ëndërr e lig, siç thotë autori. Subjekti i saj lidhet me shëndetin e njeriut, duke dhënë mundësinë për t'i trajtuar ëndrrat si një lajmëse që na paralajmëron një sëmundje, një kob apo një gëzim.

138. Sonte pashë një ëndërr të lig.

139. Sikur isha lidhurë me litarë edhe me rripa.

140. Edhe më hiqinë pse së prapa edhe nga përpara dy arapë.

141. Që të më shtienë mbë një hendek, edhe unë mezi shpëtova.

142. Po tani që u ngriçë pe gjumit

143. Leshtë më ngrihen ndë trup im, edhe më muar ethet.

Në traditën gojore prej kohësh këndohet balada e Imer Agës. Trimit përmes ëndrrës i paralajmërohet një ngjarjeje e kobtë.

Iu surdit ni anërr e zezë,

Kulla e bari ishin dredhë

Gjishja qakë ishte qorrue,

Motra e gratë ishte hutue

Ene grueja ish martue...]

Kemi shkëputur dhe një shembull bestytnie që qarkullon edhe sot nëpër Shqipëri.

110. *Edhe fjala e ligë helmon njerinë*

111. *Po ti që të mos pësosh gjë kafshë edhe të mos marrësh mbë sy*

112. *Të ngjitësh mbë prak të sipërmë edhe mbë të poshmi nga një degë pe dafine dhe pe dëllinje që të dhbonsh gjithë të këqijat.*

Në funksion të mësimdhënies shkëputëm këta shembuj nga fjalori:

127. *Edhe sharra sharron tranë.*

128. *Edhe kordha pret njerinë.*

Falë këtij punimi u munduam të risjellim në vëmendje fjalorin e Voskopojarit, falë punës së vyer të studiuesit Ilo Mitkë Qafëzezi, duke u nisur nga disa shembuj bindës se për realizimin e tij autori rrezatonte dije dhe njohuri shumë të mira sociolinguistike dhe se jo rastësisht mbështetej në etnokulturën shqiptare, të cilën e njihte aq mirë saqë i rrëfen ngjarjet sociale, zakonet, praktikat dhe besëtytnitë jo vetëm për voskopojarët, por

për gjithë Ballkanin. Numri i fjalëve që përmban ky fjalor ndoshta shkon tek 1200-1300 fjalë. Pak a shumë është një numër i përafërt me abetaret e atyre kohërave, duke i dhënë përmasat e *përtej një abetareje*, e ca më shumë nëse flasim për një version didaktik. Duam të shtojmë gjithashtu se falë këtij fjalori u deklarua historia e kombit, u komunikua me një kategori elitare përtej Ballkanit, ku bashkëjetesa, kontaktet, si dhe bashkëpunimi mes etnive nxitën Voskopojarin në përpilimin e Tetraglosit, si nevojë dijeje e kulturave tradicionale, ku faktori etnik kapërceu edhe ndasitë fetare.

Menduar që ta mbyllnim këtë punim me një fragment poezie që iu përkushtua veprës së Dhanilit prej klerikut Mihal Shqima, i cili me keqardhje deklaroi që nuk zotëron asnjë gjuhë, të cilat do t'i shtonin listës së virtyeteve njerëzore edhe mirënjohjen.

‘Do të desha të kem si gjuhë ato gjuhëra të katra
për të mundur të përfaqësoj vetëm mirënjohurinë
e cila s’është thotë, një nga burrat e qemoçmë
është shenjë mirënjohje, ndër të mëdhenj e të vegjël.²⁰ ...

BIBLIOGRAFI

Hamiti, A. – Osmani, I. [Shkup], *Ndihmesa e Thimi Mitkos në leksikon e Shqipësisë*, Konferencë shkencore Ndërkombëtare kushtuar jetës dhe veprës së Thimi Mitkos në 195-vjetorin e lindjes, Tiranë 2015, f. 83-89.

<http://telegraf.al/opinion/akademik-xhevat-lloshi>: ‘Në hullinë e fjalorëve të shqipërisë me greqishten’

<http://www.scribd.com/doc/27159724/Histori-e-Letersise-Shqiptare-Elsie-Robert-1995#scribd>

Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) II, Botim i Institutit të Folklorit, Tiranë, 1961.

Mitko, Th., *Bleta Shqiptare, Vepra*. Përgatiti për botim Qemal Haxhihasani, 1981, Botim i Akademisë së Shkencave.

Qafëzezi, I. M., *Dhaniel Mihal Adham Haxhi Voskopojar*, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike.

Sala, Sh., *Fjalori Italisht-Greqisht-Shqip i Thimi Mitkos*, West Print – Tiranë, 2013.

Skëndi, S., *Studime kulturore ballkanike*, 1980, përktheu Artan Puto.

²⁰ I. M. Qafëzezi, *Vepër e cituar*, f. 49.

Fjalorët shumëgjuhësh që promovuan kombe

Visaret e Kombit, Vëllimi II, Mbledhë e redaktuëm nga At Berndardin Palaj dhe At Donat Kurti, Tiranë 1937, f. 250.

Xhagolli, A., *Fjalorët e Thimi Mitkos në vështrim etnokulturor*, Konferencë shkencore Ndërkombëtare kushtuar jetës dhe veprës së Thimi Mitkos në 195-vjetorin e lindjes, f. 330-337.

GRAMATIKË, HISTORI GJUHE

